



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË  
19.12.2024

Me datë 19.12.2024, u mbajt mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Jona Leqejza, Hilmi Lakti, Edmond Ndou, Uarda Gjekaj, Bledianë Nika, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Erald Erkocaj, Armela Brahimi, Mirsad Bashi, Ardit Taflaj, Hedije Nasa, Alma Mehmetaj, Gezim Galiqi, Erlinda Kavaja, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Florian Bjanku, Izmira Rusi, Joniz Osmanagaj, Elmira Ndervashaj, Artan Haxhi, Elis Doci, Valjeta Bajraktari, Ardit Behri, Eliona Shkreli, Gjenarin Kapcari, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Ervin Brahimi, Ervin Brahimi, Marina Duhani, Erkan Hoxha, Vjoleta Përndrecaj, Gloria Shllaku, Gjovalin Ndoj, Erkam Hoxha, Samed Bushati, Fatmir Vojvoda, Anita Amuli, Imeldi Sokoli, Muharrem Shkjau, Amila Lici, Plarent Anamali, Jetmira Rraboshta.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit **Z.Oltion Luli**  
Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Nëntor 2024".
2. Pr/Vendim: "Për miratimin e nivelit të bursave për nxënësit e viteve të para, viteve të dyta e lart të shkollave të mesme për vitin shkollor 2024-2025".
3. Pr/Vendim: "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës".

**Z.Luli** shton se rendit të ditës së kësaj mbledhje i shtohen edhe dy pr.vendime të tjera:

1. Pr/Vendim: "Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026".
2. Pr/ Vendim: "Për dhënien në përdorim, pa kundërshtim të pronës transferuar me VKM nr.12 /21, datë 02.06.2010 (Tregu Rus) në favor të shoqërisë aksionare BIO Strajca me qëllim mirëfunksionimin e tregjeve publike".
3. Pr/ Vendim: "Për dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri".

Së pari për procedurë **Z.Sokoli** merr fjalën dhe në emër të grupit kërkon të dijë cila është baza ligjore që është ndjekur nga Bashkia Shkodër, në një moment që kemi anashkalim të të gjitha afateve për buxhetin që na paraqitet sot për miratim. Ai shton se tashmë po vijnë përherë pr/vendime jashtë rendit të ditës, të cilat në fakt nuk kanë asnjë lloj urgjence përjashtoj këtu pr/vendimin mbi ndihmën financiare për zjarret. Ku është bazuar Bashkia Shkodër për të filluar shqyrtimin e Buxhetit kur duhen minimalisht 10 ditë pune para?

Përgjigjet **Z.Luli** në lidhje me procedurën që është ndjekur. Përsa i përket kalendarit të PBA dhe programit përfundimtar të Buxhetit nga Bashkia Shkodër janë zbatuar me përpikmëri të gjitha afatet po ashtu edhe konsultimet publike janë zhvilluar në përpikmëri sipas kalendarit të paracaktuar. Kurse për afatin e publikimit, duke patur parasysh ligjin që ju cituat prej 20 ditësh pune, do të thotë që buxheti të miratohet me 1 Janar të vitit të ardhshëm. Prandaj në lidhje me afatet përsëri i referohemi ligjit 139 dhe ligjit 44 përsa i përket procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë ( citon këtu) nenin 56 lidhur me afatet. Në këtë rast nuk është anashkaluar asnjë afat, aq më tepër që materialet lidhur me Buxhetin 2025-2027 janë dërguar tek të gjithë Këshilltarët me datë:05.12.2024, prandaj mundësia për shqyrtim dhe për të qënë korrekt me të gjitha ato që kërkon ligji është përmbushur Nga administrata e Bashkisë dhe nga Këshilli bashkiak.

**Z.Sokoli** përsëri shprehet se data 30 Nëntor për paraqitjen e buxhetit është data përfundimtare sipas ligjit për financat prandaj Buxheti mund të ishte paraqitur edhe më përpara. Lutemi që të respektohen afatet që të mos kemi të tilla diskutime në vazhdimësi.

Fjalën e merr **Z.Bjanku** dhe shprehet se grupi i BF-së ka paraqitur një Kërkesë/propozim për rritjen e fondit të kushtëzuar prej 6% për ndihmën ekonomike dhe vërejmë që nuk është marr në konsideratë ky propozim.

Sqaron përsëri **Z.Luli** që në këtë rast duhet hartuar një Pr/vendim i shoqëruar me relacionin përkatës, i cili duhet të kalojë në drejtorinë e financës dhe komisionet përkatëse duke qënë se ka efekte financiare.

Hidhet në votim Rendi i ditës së bashku me pikat shtesë, ku rezultojnë **31** vota Pro **12** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet edhe me votimin e zbardhjes së pr/verbalit të mbledhjes së Këshillit bashkiak të datës: 06.11.2024, i cili miratohet.

Kalohet në pikën e parë të rendit të ditës: Pr/ Vendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Nëntor 2024”.

Siç është rënë dakord ky pr/akt s’ka nevojë për relativitet prandaj kalohet në votimin e kësaj pike, ku rezultojnë **46** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e dytë të rendit të ditës: Pr/Vendim: “Për miratimin e nivelit të bursave për nxënësit e viteve të para, viteve të dyta e lart të shkollave të mesme për vitin shkollor 2024-2025”.

Relaton për këtë pikë **Znj.Dama**, drejtoreshë arsimit në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Pyetje dhe diskutime nuk ka. Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike, të cilët shprehen pro pr/aktit.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **46** vota Pro, **0** Kundër, **0** Abstenim.

**Miratohet**

Z.Luli propozon që të vijohet me pikat shtesë të rendit të ditës, duke qënë se pika 3. Ka nevojë për më shumë kohë për prezantim. Hidhet në votim propozimi, ku rezultojnë **31** vota Pro **15** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

**Znj.Haxhi** relaton shkurtimisht për pikën e parë shtesë: Pr/Vendim: "Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026"

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort, kurse Z. Osmanagaj nga koalicioni BF dhe Z.Sokoli shprehen kundër për procedurë.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **29** vota Pro, **16** Kundër, **0** Abstenim.

**Miratohet**

Vijohet me pikën e rradhës: Pr/ Vendim: "Për dhënien në përdorim, pa kundërshtim të pronës transferuar me VKM nr.12 421, datë 02.06.2010 ( Tregu Rus) në favor të shoqërisë aksionare BIO Strajca me qëllim mirëfunksionimin e tregjeve publike".

Relaton për këtë pikë **Z.Mema**, drejtor i përgjithshëm i drejtorisë për zhvillimin ekonomik në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e merr **Znj.Bajraktari** e cila thotë se vitin e shkuar është miratuar për këtë sh.a një fond prej 10 milionësh, dhe tek tabelat që na paraqiten sot kemi vetëm parashikimet për vitin 2025. Nuk kemi asnjë informacion tjetër për këtë njësi , që ka 13 punonjës dhe që për vitin e ardhshëm është parashikuar një fond prej 20milionësh. Dhe në fund të vitit Bio Strajca del me humbje me 7 milion e 800 mijë lek. A mund të kemi një sqarim për këtë?

Përgjigjet për këtë në nënyrë të detajuar **Z.Brahimi**, administrator i Bio Strajca sh.a, duke theksuar që nuk është parashikuar asnjë shtesë kapitali në këtë buxhet.

~~Z.Sokoli merr fjalën dhe thotë se përsa i përket investimit që është dhënë nga AZHBR nuk është parashikuar asnjë sh.a në mars të 2023, pra është parashikuar që ky fond të menaxhohet nga vetë Bashkia.~~

Ndërhyn dhe sqaron **Z.Mema** duke thënë se që prej thirrjes , ku është dhe baza ligjore e krijimit të kësaj sh.a , ka qënë kriter ndërtimi i saj. Me VKB nr 15 datë 20.07.2023, thirrja ka qënë në proces dhe kërkesë primare ka qënë krijimi i sh.a për menaxhimin e tregjeve.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **31** vota Pro, **14** Kundër, **2** Abstenim.

**Miratohet**

Kalohet tek pika e rradhës : Pr/ Vendim: "*Për dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri*". Me kërkesë të Këshilltarëve bihet dakort që kjo pikë nuk ka nevojë të relatohet prandaj kalohet në votimin e saj, ku rezultojnë **48** vota Pro, **0** Kundër, **0** Abstenim.

**Miratohet**

Vijohet me pikën 3. të rendit të ditës: Pr/Vendim: "*Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës*".

Fjalën e merr **Z.Beci**, kryetar i Bashkisë Shkodër, i cili paraqet një panoramë të përgjithshme të këtij pr/buxheti, i cili përmes investimeve dhe projekteve strategjike do ta ktheje Shkodrën në Kryeqendrën e Zhvillimit Rajonal.

**Z.Luli** shprehet se për detajet teknike të Buxhetit do na flasi në mënyrë të detajuar Znj.Haxhi, drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit në Bashkinë Shkodër dhe më pas do kalohet në pyetje dhe diskutime sipas procedurës.

**Z.I.Sokoli** dhe **Znj.Shllaku** shprehen se si fillim duhet të diskutohet mbi atë ç'ka u prezantua dhe më pas të kalohet tek detajet teknike. Po ashtu edhe **Znj.Shkrela** dhe **Z.Shkjau** kërkojnë që t'i jepet fjala për këtë, por **Z.Luli** sqaron përsëri se sipas procedurës së përherëshme do bëhet prezantimi më pas do kalohet në pyetje e diskutime.

**Z.Luli** kërkon 5 minuta pushim për shkak se Këshilltarët e Kualicionit BF, dhe grupit të PD kanë bllokuar foltoren duke kërkuar të marrin fjalën në kundërshtim me rregulloren.

Pas rifillimit të seancës Kryetari i Këshillit i bën të ditur Këshilltarëve takimin e zhvilluar me kryetarët e grupeve politike, **Z.Ndou** kryetar i grupit të PS, **Z. Gj.Sokoli** kryetar i grupit të PSD dhe **Z.Osmanagaj** zv/kryetar i kualicionit BF. në mungesë **Z.Gjylbegaj**, i cili nuk u paraqit. **Z.Osmanagaj** pasi u konsultua me këshilltarët e grupit të tij politik shpreh padakortësi për prezantimin e buxhetit nga Znj.Haxhi pa diskutuar më parë me Kryetarin e bashkisë.

**Z.Luli** në mënyrë të përsëritur kërkon lejimin e prezantimit të detajeve teknike të buxhetit nga Znj.Haxhi, por edhe pas kërkesave të njëpasnjëshme këshilltarët e Kualicionit BF dhe ato të grupit të PD-së nuk janë dakort dhe shprehin mosbindje ndaj kryesuesit të mbledhjes së Këshillit bashkiak duke dalë në foltore dhe duke krijuar skenë të paprecedentë.

Me kërkesë të kryetarit të grupit të PS-së **Z.Ndou** dhe **Z. GJ.Sokoli** kryetar i grupit të PSD-së kërkohet hedhja në votim të pr/aktit meqënëse pyetje dhe diskutime lidhje me të nuk ka.

Në të tilla kushte **Z.Luli** detyrohet të kalojë në votimin e pr/aktin. Këshilltarët e Kualicionit BF dhe të Grupit të PD nuk marrin pjesë në votim, me përjashtim të **Z.Vojvoda** i cili voton Pro këtij pr/akti.

Pr/Vendimi: "*Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës*", hidhet në votim, ku rezultojnë **30** vota Pro. **Miratohet**

**Z.Luli** e deklaroi mbylljen të mbledhjes.

*Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër të datës 19.12.2024. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).*

Procesverbali përmban 5 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

**V.o:** Ky procesverbal do miratohet nga anëtarët e Këshillit në mbledhjen e rradhës së Këshillit bashkiak.

**Sekretar**

**Sabina DANAJ**



Zbardhi Pr/verbalin:

**Irma Sulishti**



**KRYETAR**

**Oltion LULI**

